



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 9164 prot.

Vlorë, më 19 03 2024

PROJEKT -VENDIM

PËR

**MIRATIMIN E VLERËS FINANCIARE TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA
DJEGIA E BANESËS TË Z.KRISTAQ PIPERI DHE SHPËRBLIMIN FINANCIAR
NGA ANA E BASHKISË VLORË.**

Këshilli i Bashkisë Vlorë në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 2, neni 9/1 pika b, neni 29/1, neni 54 pika dh ,të ligjit nr.45/2019 datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen civile”,në VKM Nr. 329 data 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” paragrafi III/ë dhe pika 3/a, pasi mori në shqyrtim materialin e përgatitur nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Drejtoria e Financës dhe Këshilli i Qarkut Vlorë,

VENDOSI:

1.Të miratojë vlerën financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia në banesën e Z.Kristaq Piperi ,e ndodhur në lagjen “Hajro Çakërr”,Rajoni Nr1 Bashkia Vlorë, në datën 28.11.2023, sipas preventivit të hartuar nga ekspertët e Këshillit të Qarkut Vlorë përkatësisht në masën:

A. 568.592 (pesëqind e gjashtëdhjet e tetë mijë e pesëqind e nëntëdhjet e dy) lekë për punime ndërtimi. (1.137.185x50%)

B. 445.571(katërqind e dyzetë e pesë mijë e pesëqind e shtatëdhjet e një) lekë për mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake

- Shpërblimi financiar do të përballohet nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile të Bashkisë Vlorë.
- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financë-Buxhetit dhe Drejtoria e Mbrojtjes Civile pranë Bashkisë Vlorë.
- Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015,neni 55 pika .

Konceptoi:*E.Kamberi*

Miratoi:*A.Vreshtazi*

KRYETAR
ERMAL DREDDHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 4164 prot.

Vlorë, më 19.03 2024

RELACION

PËR

PROJEKT-VENDIMIN “MIRATIMIN E VLERËS FINANCIARE TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA DJEGIA NË BANESËN E Z. KRISTAQ PIPERI DHE SHPËRBLIMI FINANCIAR NGA ANA E BASHKISË VLORË “

Në zbatim të VKM Nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”.

Komisioni i Bashkisë Vlorë i ngritur me Urdhërin e Brendshëm Nr.301 datë 08.09.2023 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë ,shkoi në banesë për të konstatuar dëmet e shkaktuara nga djegia.

Kristaq Piperi në datën 14.12.2023 ka paraqitur kërkesën me Nr15675 prot, për shkak të djegies së banesës e ndodhur në lagjen "Harjo Çakërri", Rajoni Nr.1, Bashkia Vlorë.

Mbas hartimit të proces-verbalit të konstatimit të gjendjes së banesës në datë 15.12.2023, është vijuar me shkresën përcjellëse me Nr.15675/1 prot, datë 26.01.2024 Dërgohet dokumentacioni për banesën e djegur të z.Kristaq Piperi, në Këshillin e Qarkut Vlorë për të vazhduar me preventivat e vlerësimit të dëmeve nga komisioni i ekspertëve.

Këshilli i Qarkut Vlorë me shkresën Nr.2633, datë 20.02.2024 “Dërgim preventivi dhe dokumentacioni i banesës së djegur të z.Kristaq Piperi ka dërguar preventivin e hartuar nga komisioni i ekspertëve, nga ku rezulton:

- Vlera e dëmeve në banesën e z.Kristaq Piperi është 1.014.163 (një million e katërbëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjet e tre) lekë.

Aktualisht Bashkia Vlorë ka mundësi financiare për të ndihmuar familjet për banesat e djegura.

Për sa më lart i kërkojmë Këshillit të Bashkisë të miratojë vlerën financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia në banesat e z.Kristaq Piperi sipas preventivit të hartuar nga ekspertët e Këshillit të Qarkut Vlorë dhe shpërblimin financiar i cili do të përballohet nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile të Bashkisë Vlorë.

Konceptoi: *E.Kamberi*



DREJTOR

Adrian Vreshtazi

